

VENDIM
Nr. 234, datë 29.10.2024

**SHFUQIZIMIN E SHKRONJËS “E”, TË NENIT 40, TË RREGULLORES “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM TË KËSHILLIT TË
LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9; të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 164, 189, pika 1, germa “b”; dhe 190, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, miratuar me vendimin nr. 407, datë 17.12.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të shfuqizohet shkronja “e”, e nenit 40, të saj.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot, më 29.10.2024.

KRYETAR
Mirela Bogdani